



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 288, Datë 09.10.2023

MBI  
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1798/8 prot., datë 05.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1798/1 prot., datë 04.09.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 274, datë 19.09.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës të shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.09.2023 dhe 21.09.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1798/6 prot., datë 22.09.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 08.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**Votimi i Bordit të ERE-s për,**

**VENDIMIN**

**Nr. 288, Datë 09.10.2023**

**MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

**Pro**

**Kundër**

**Petrit Ahmeti**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Erjola Sadushi**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Maksim Shuli**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Raimonda Islamaj**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Petra Lika**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_